

# OUCH!

## NË KËTË BOTIM..

- Auto-complete
- Cc: / Bcc:
- Listat e shpërndarjes
- Emocioni & Privatësia

## Çka të bësh e të mos bësh me Email

### Përmbledhje

Emaili është bërë një nga mënyrat kryesore se si komunikojmë ne, edhe në jetën private dhe atë profesionale. Por, ne mund të shndërrohemi në një armik me mënyrën si e përdorim emailin. Në këtë broshurë ne do të sqarojmë gabimet më të shpeshta që njerëzit bëjnë duke përdorur emailin dhe mënyrat si mund t'i shmangim këto gabime gjatë jetës sonë të përditshme.

### Autori i ftuar

Dr. Eric Cole (@drericcole) është aktivisht i përfshirë me Institutin e Teknologjisë SANS (STI) dhe duke punuar me studentë dhe duke i ligjëruar atyre. Ai është pjesë e stafit të ligjëruesve dhe autor i kurseve në SANS. Dr.Cole është një udhëheqës në industri ku ai jep këshilla dhe konsulencë të veshme mbi sigurinë në Internet.

### Auto-Complete

“Auto-complete” është një funksion që gjendet nëpër plot klientë të emailit. Sapo ju të filloni të shkruani emrin e personit të cilit doni t'i shkruani email, softueri juaj i emailit e zgjedh atë automatikisht. Kështu ju nuk keni nevojë të mbani mend adresat e emaileve të të gjithë kontakteve tuaja, mjafton emri i pranuesit. Problemi me këtë funksion është që shumë kontakte tuajat kanë emra të ngjashëm. Ndodh shpesh që ky funksion të zgjedhë një adresë të gabuar emaili. Për shembull, ju mund të dëshironi t'i shkruani një email me të gjitha të dhënat financiare të kompanisë suaj të “Fred Smith”, bashkëpunatori juaj në zyrën e kontabilitetit. Por në vend të tij, ‘auto-complete’ e përzgjedh “Fred Johnson”, fqinjin tuaj. Kështu ju i dërgoni të dhëna shumë të ndieshme personave të paautorizuar. Për t'u mbrojtur nga ky gabim, gjithmonë verifikoni dy herë emrin dhe adresën e pranuesit para se të shtypni butonin “Dërgo” (ang. Send).

### Cc / Bcc

Shumica e klientëve të emaileve kanë dy opsione përveç fushës “To”: pra atë “Cc: dhe Bcc:”. “Cc” qëndron për shkurtesën “Carbon copy” që do të thotë se doni t'i mbani të informuar njerëzit. “Bcc” do të thotë “Blind carbon copy” që është e ngjashme me Cc, por askush nuk mund ta dijë se cilët persona janë në fushën Bcc. Të dy këto opsione mund të ju shkaktojnë probleme. Kur dikush ju dërgon email juve dhe në rreshtin Cc ka vendosur persona tjerë, ju duhet të vendosni a do t'i përgjigjeni vetëm dërguesit, apo të gjithëve të përfshirë në atë email. Nëse përgjigja juaj është e ndieshme, ju do të donit t'i përgjigjeni vetëm dërguesit. Nëse dëshironi këtë

## Çka të bësh e të mos bësh me Email

atëherë sigurohuni që nuk e përdorni opsionin “Reply All” që përfshin të gjithë në email. Me opsionin Bcc mund të keni një problem tjetër. Kur dërgoni një email të ndieshem te një grup, ju mund të përfshini dikë privatisht në fushën Bcc, p.sh.shefin tuaj. Por, nëse shefi juaj përgjigjet me “Reply All”, të gjithë pranuesit do ta kuptojnë që ju keni vendosur shefin tuaj në Bcc në emailin fillestar.

### Listat shpërndarëse

Listat shpërndarëse (ang. Distribution lists) janë grupe emailësh të përfaqësuara nga një adresë e vetme emaili, që nganjëherë quhet listë e emailave ose emër grupi. Për shembull ju mund të keni një listë shpërndarëse me adresë emaili group@shembulli.com. Kur ju i dërgoni një email kësaj adrese, mesazhi i dërgohet të gjithë të anëtarësuarve në atë grup, ndoshta qindra ose mijëra pranuesve. Duhet të keni kujdes se çka dërgoni në një listë shpërndarëse sepse shumë njerëz mund ta marrin atë mesazh. Gjithashtu, kini shumë kujdes kur i përgjigjeni dikujt në email që gjendet në një listë shpërndarëse. Ju mund të dëshironi t'i shkruani një dërguesi të veçantë, por përsëri nëse e shtypni “Reply All” ju do të përfshini të gjithë listën shpërndarëse, që do të thotë se qindra në mos mijëra njerëz tani janë duke lexuar emailin tuaj privat. Ajo që mund të jetë edhe më e rrezikshme është që funksioni ‘auto-complete’ të ketë përzgjedhur automatikisht një listë shpërndarëse. Ju mund të doni t'i shkruani p.sh. një personi, bashkepuntori tuaj, Carl, në adresën carl@example.com, por ‘auto-complete’ gabimisht mund të përzgjedhë gabimisht një listë shpërndarëse për makina që ju mund të jeni antarsuar.

### Emocionet

Kurrë mos dërgoni email nëse jeni të emocionuar. Nëse ju jeni në një gjendje emocionale, ai e-mail mund të ju shkaktojë dëme në të ardhmen, ndoshta t'ju kushtojë me një shoqëri apo edhe me humbje të vendit të punës. Në vend të kësaj, qetësohuni pak dhe në mënyrë të matur organizoni mendimet tuaja. Nëse doni patjetër të zbrazni mllefin tuaj, hapeni emailin dhe sigurohuni që nuk jeni duke ja adresuar askujt. Shkruani aty saktësisht atë që ndjeni. Pastaj ngrituni dhe largohuni nga kompjuteri juaj, ndoshta bëni një çaj. Kur të ktheheni në tavolinën e punës, fshijeni atë email dhe rifilloni punën. Ose merreni telefonin dhe flisni direkt me personin që doni t'i shkruani, sepse është e vështirë të dihet qëllimi apo toni i mesazhit vetëm me anë të emailit.



*Emaili nuk ka buton “Zhbëje” (ang. Undo). Kurdo që ju dërgoni një email, ndaloni për një çast dhe kontrollojeni se çka jeni duke dërguar dhe te kush para se të shtypni butonin “Dërgo” (ang. Send)*

## Çka të bësh e të mos bësh me Email

### Privatësia

Në fund, mos harroni që emaili tradicional ka pak mbrojtje të privatësisë, emaili juaj mund të lexohet nga kushdo që ka qasje në të. Gjithashtu, për dallim nga një thirrje apo diskutim i drejtpërdrejtë, në momentin kur dërgoni email ju nuk keni më kontroll mbi të. Emaili juaj mund të dërgohet fare lehtë te persona tjerë, mund të publikohet në forume, edhe mund të jetë i qasshëm në Internet përgjithmonë. Nëse keni diçka vërtetë private për të diskutuar, thërrisni në telefon. Është poashtu me rëndësi të mbani mend që në shumë shtete, emaili mund të përdoret si dëshmi në gjyq. Në fund, nëse e përdorni kompjuterin e punës për të shkruar email, mbani mend që punëdhënësi juaj ka të drejtë të monitorojë e madje edhe të lexojë emailin tuaj. Kjo mund të përfshijë edhe emailin tuaj personal nëse e hapni atë nga kompjuteri i punës për t'ju qasur llogarisë suaj personale. Pyesni mbikqyrësin tuaj nëse keni pyetje për privatësinë e emailit në punë.

### Mëso më shumë

Regjistrohuni në buletin tonë mujor për vetëdijësimin mbi sigurinë OUCH!, qasuni në arkivat e OUCH!, dhe mësoni më shumë mbi zgjidhjet për ngritjen e vetëdijes mbi sigurinë të ofruara nga SANS duke na vizituar në faqen <http://www.securingthehuman.org>.

### Edicioni në shqip

Edicioni në shqip i OUCH! është përkthyer nga gjuha angleze nga Ilir Bytyçi dhe Jorida Nano. Iliri është magjistër i shkencave në administrimin e rrjetave dhe sistemeve kompjuterike, është ligjërues në universitet për lëndë të ndryshme nga fusha e TI, dhe është përgjegjës për sigurinë e teknologjise informative në bankë. Jorida është përkthyesë profesionale e gjuhës angleze në OSBE.

### Burimet

OUCH! Email Phishing Attacks: <http://www.securingthehuman.org/ouch/2013#february2013>

OUCH! Spear Phishing: <http://www.securingthehuman.org/ouch/2013#july2013>

Terme të shpeshta të sigurisë: <http://www.securingthehuman.org/resources/security-terms>

OUCH! botohet nga SANS Securing The Human dhe shpërndahe nën licencën [Creative Commons BY-NC-ND 3.0](http://creativecommons.org/licenses/by-nc-nd/3.0/). Lejohet ta shpërndani këtë buletin ose ta përdorni për programet tuaja vetëdijësuese, për sa kohë nuk e modifikoni përmbajtjen e buletinit. Për përkthimet apo më shumë informata, ju lutemi na kontaktoni në [ouch@securingthehuman.org](mailto:ouch@securingthehuman.org).

Bordi editorial: Bill Wyman, Walt Scrivens, Phil Hoffman, Bob Rudis

Përkthyer nga: Ilir Bytyçi dhe Jorida Nano